



A.nr.353/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, më Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.353/2026, të datës 26.03.2026, të parashtruar nga ankuesi G.K, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit Taulant Ferizi nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.05.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.353/2026, e datës 26.03.2026, e parashtruar nga ankuesi, G.K.

**II. Mbetet** në fuqi Vendimi me numër protokoll Nr. 02 Nr.112/01-0007274/26, i datës 24.02.2026, i Njësisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, G.K (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 26.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll Nr. 02 Nr.112/01-0007274/26, i datës 24.02.2026, i Njësisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova:** Ankesa me numër protokoll 1529/2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ; Ankesa me numër protokoll An.nr. 8036/2025 të datës 23.12. 2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 21.11.2025; Përgjigje me nr.02-112/01-0049895/25 të datës 24.11.2025; Akt Emërimi i datës 03.08.2020; Përshkrimi i detyrave të punës; Kopja e letërnjoftimit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.01.2026 dhe Përgjigje në ankesë e datës 16.01.2026 nga organi i punësimit; Vendimi me numër A.nr.2066/2025 i datës 06.02.2026 i KPMSHCK-

së; Vendimi i datës 02.03.2026 i KPMSHCK-së për korigjimin e vendimit me numër A.nr.2066/2025 i datës 06.02.2026 i KPMSHCK-së; Vendimi me numër protokoll Nr. 02 Nr.112/01-0007274/26, i datës 24.02.2026, i Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi sipas Akt-it të emërimit me Nr. Protokoll 02-112/01-0030202/2020, të datës 03.08.2020, ankuesi ushtron pozitën e punës *Zyrtare për Menaxhimin e Mbeturinave* në Drejtorinë e Shërbimeve Publike-Sektori për Shërbime Publike.

Ankuesi më datë 21.11.2025, përmes postës elektronike ka parashtruar kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt, për sistematizimin e pozitës së tij në kategorinë Specialist, klasa GJ12, me koeficient (6.54), ndërsa, Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt, përmes përgjigjes në kërkesë të datës 24.11.2026, ka njoftuar se ankuesi posedon kualifikimin Bachelor në Agroekonomi, i cili drejtim nuk përfshihet në grupin e specialistëve të kërkuar për këtë pozitë, sipas rregullores dhe katalogut të vendeve të punës për shërbimin civil të punës. Kjo pozitë klasifikohet në Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, përkatësisht në fushat: Inxhinier i Mjedisit, Mjedis, Kimi e Përgjithshme, Biologji, Ekologji dhe Gjeografi.

Ankuesi më datë 23.12.2025, kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK, që ti mundësohet klasifikimi i pozitës së tij të punës nga kategoria profesionale 2 me koeficient 7 në kategorinë Specialist GJ12 me koeficient (6.54).

KPMSHCK-ja më Vendimin A.nr.2066/2025, të datës 06.02.2026, ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 23.12.2025, dhe ka obliguar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt, të shqyrtojë kërkesën e datës 21.11.2025 të parashtruar nga ankuesi, dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt në zbatim të vendimit të KPMSHCK-së me numër A.nr.2066/2025, të datës 06.02.2026, më Vendimin me numër protokoll Nr. 02 Nr.112/01-0007274/26, i datës 24.02.2026, i Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt ka refuzuar kërkesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi sërish ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar Vendimit me numër protokoll Nr. 02 Nr.112/01-0007274/26, i datës 24.02.2026, me pretendimin ankimor që ti mundësohet klasifikimi i pozitës së tij të punës nga kategoria profesional 2 me koeficient GJ37 (4.9) në kategorinë Specialist GJ13 me koeficient (6.52). Kërkon nga këshilli që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të nxjerrë akt emërim të ri, duke e klasifikuar në kategorinë e Specialistëve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll Nr. 02 Nr.112/01-0007244/26, i datës 24.02.2026, i Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt, pretendon se vendimi i kundërshtuar është nxjerr pa bazë faktike dhe juridike, duke pretenduar se po i mohohet e drejta për kategorizim si Specialist edhe pse konsideron që plotëson kërkesat e përgjithshme formale për këtë. Kështu që vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar, të detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt të nxjerr akt të ri për klasifikimi në kategorinë e specialistëve GJ12 më koeficientin 6.54, përkatësisht 7.54, si dhe kërkon që të obligohet Komuna e Skenderajt që diferencën e pagës ta kompensoj në mënyrë retroaktive nga muaji nëntor 2023 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në kuptim të shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit iu referua ju referua bazës ligjore si me poshtë:

Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, përkatësisht:

*-Neni, 2 paragrafi 1: ''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*,

*-Neni 14, paragrafi 3, të: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publikë.*

Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht:

*-Neni 38, paragrafi 2: 2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoresh/in ne përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoresh/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoresh/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtoresh/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional.*

Rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kurse klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil, e në ndërlidhje me këtë, kolegji, konstaton se ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune në Komunën e Skenderajt sipas konkursit me Nr. 111/01-0023838/19 të datës 24.04.2019, për pozitë Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave, ku sipas

konkursit, klasa e pozita Profesional 2, e për rrjedhojë kjo procedurë dhe kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuar sipas konkursit kanë qenë duke ju referuar Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit, ndërsa pozita e specialistëve si kategori e pozitave të shërbimit civil janë përcaktuar vetëm sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që ankuesi nuk ka themeluar marrëdhënie pune sipas Kategorisë së Specialistëve por ka themeluar marrëdhënie pune sipas Kategorisë Profesionale, klasës profesional 2. Kolegji i Këshillit, konstaton se Komuna e Skenderajt është bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht sipas shtojcës Nr.2 të kësaj rregullore, pozita e ankuesit *Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave* është klasifikuar më kategorinë profesionale, klasa 2, Grupi i Përgjithshëm i Mjedisit.

Në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore Kolegji ju referuar Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht:

*-Neni 8: Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje, (më Shtojcën Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi për klasën e specialistëve është përcaktuara: “Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave”, kurse si kushte formale për këtë kategori janë paraparë: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji, pylltari, bujqësi, veterinari, gjeografi, ambient, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtime arsimore.*

*-Neni 27 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

Andaj Kolegji i Këshillit, referuar faktit të pakontestueshëm që pozita e ankuesit sipas Rregullores Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, është kategorizuar në kuadër të kategorisë profesionale, klasës profesional 2, atëherë në kuptim të nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nuk mund të bëhet kategorizimi i pozitës së ankuesit si Specialist, sepse fillimisht kategorizimi duhet të parashihet sipas rregullores për Organizimin e Brendshëm e pastaj procedurat të tjera të parapara sipas Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, shtu këtu faktin se pozita që mban ankuesi është rekrutuar si pozitë e kategorisë profesionale, ndërsa pozita Specialist është kategori tjetër, atëherë, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të Vendimit 02-112/01-0007274/2026 të datës 24.02.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, konstaton se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje esenciale procedurale dhe materiale dhe për rrjedhojë ka pasqyruar në

mënyrë të drejtë dhe të saktë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe i njëjti është plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Thënë si më lart, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.353/2026*

**Sabile Avdyli**

\_\_\_\_\_  
*Procesmbajtëse*

**Eshref Shabani**

\_\_\_\_\_  
*Kryetar i Kolegjit*

### **Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të autorizuar avokatit Taulant Ferizi
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.